Autori me skafandër zbret nga motori dhe hedh eksplozivin, detaje nga shpërthimi në Shkodër. Dëshmia e pronares së banesës: S'kam konflikte!

Senad Nikshiqi | 25 Mars, 2024 09:45

Madhësia e tekstit:

Një shpërthim tritoli ndodhi në orët e para të mëngjesit të sotëm në Shkodër në banesën e shtetases Frida Sala 62 vjeçe. Ka qenë ora 3:40 kur eksplozivi shpërtheu në shtëpinë e 62-vjeçares. Nga kjo ngjarje ka vetëm dëme materiale të shkaktuara në derën e shtëpisë, mure dhe dritaret që janë thyer dhe një automjet që ndodhej i parkuar.

Ndërkohë brenda banesës ka qenë e gjithë familja Sala, 62-vjeçarja bashkë me djalin, bashkëshortin dhe fëmijët. Menjëherë në vendin e ngjarjes mbërritën forcat e policisë duke nisur hetimet për vendosjen e sasisë së tritolit. Efektivët kanë arritur që të sigurojnë pamjet e momentit të autorit të dyshuar i cili vjen me një motorr me skafandër në kokë dhe pasi hedh lëndën eksplozive në banesën e familjes Sala largohet me shpejtësi. Nga kamerat policia nuk ka arritur që ta identifikohej autorin deri më tani për shkak të skafandrës që mbante në kokë. 62 vjeçarja Frida Sala e cila punon në doganën e Hanit të Hotit tek peshorja duke peshuar mallrat që hynë e dalin në atë doganë ka deklaruar se nuk ka konflikte me askënd.

Shtetasja Frida Sala deklaroi se ishin zgjuar dhe po bëheshin gati për të ngrënë vaktin e syfyrit duke qenë se agjërojnë në këtë muaj të shenjtë të Ramazanit. 62 vjeçarja del në pension për pak muaj dhe policia për momentin nuk e lidh ngjarjen me punën e saj. Policia ka marrë në pyetje edhe djalin e 62-vjeçares, shtetasin Dori Sala, i cili po ashtu ka deklaruar se nuk ka konflikte me askend dhe se nuk e di se kush mund të jenë autorët. Ky i fundit punon në një kompani interneti dhe nuk njihet si një person problematik. Vëllai tjetër ndodhet në Itali dhe punon si shofer kamioni. Deri më tani për policinë është i paqartë motivi i kësaj ngjarje. E gjithë familja bashkë me komshinjtë në një rrugicë të vogël në lagjen "Tom Kola" në Shkodër janë tronditur nga ky shpërthim i fortë i cili është dëgjuar në gjithë atë zonë. Policia dhe prokuroria e Shkodrës vijojnë hetimet për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarje të ndodhur në Shkodër.

(BalkanWeb)

Sponsored Links

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: Shkoder shperthim

TË NGJASHME

Rikthehet bora në Shkodër, si paraqitet situata me rrugët
25 Mars, 2024

Shpërthim me tritol në oborrin e banesës në Shkodër, policia nis hetimet
25 Mars, 2024

Taboola Feed

"Nuk kam parë kurrë në jetë", qengji i porsalindur trondit fermerin
balkanweb.com

Me shpejtësi skëterrë në rrugë/ Policia me 'dorë të hekurt', ndëshkon me gjoba mijëra shoferë
balkanweb.com


MOST POPULAR
Sylvinho ndryshon Shqipërinë, trajneri "përzien kartat", edhe në Suedi "lëgjin" e bëjnë tifozët kuqezi
balkanweb.com

MOST POPULAR
Detaje/ Si do të organizohen kampet në Shëngjin dhe Gjadër, ja si do të bëhet shpërndarja e refugjatëve. Nëse dalin...
balkanweb.com

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Me kallashnikov pa leje kryenin qëllje gjatë natës dhe postonin videot në TikTok, 6 të arrestuar në Durrës
25 Mars, 2024

U arrestua për shpërdorim detyre, jepet nesër masa e sigurisë për kryebashkiakun Jorgo Goro
25 Mars, 2024

Erjon Bani zgjidhet zëvendëskryetar i GJKKO-së, zëvendësson Irena Gjokën
25 Mars, 2024

Plagosja në Pogradec, sherri mes vëllezërve për motive të dobëta, në momentin e ngjarjes autori...
25 Mars, 2024

Përfshihet nga flakët banesa në Milot, shpëton mekullisht çifti i të moshuarve
Enver Doçi | 25 Mars, 2024

Goditi me grushte dhe shkelma një të mitur, arrestohet 72-vjeçari në Elbasan
25 Mars, 2024

KATEGORIA VIDEO

Rizoto kremoz që shkrin në gojë
25 Mars, 2024

"Komisionet, njollë e zezë e parlamentarizmit", Petro Koçi nga komisioni hetimor për shëndetësinë: Janë thënur skifteri, të mos kemi histori kacafytjesh
25 Mars, 2024

Kek me muesli pa gluten
25 Mars, 2024

"Marrim kusi dhe kazanë", Korreshi ironizon te Komisioni Hetimor për shëndetësinë: Shpallni aksionin opozitar se na mallëngjyet
25 Mars, 2024

Unmute

Debate në komisionin për koncesionin e sterilizimit dhe Check-Up/ Deputeti i PS kapet me Vokshin: Jo deklarata partiake, të respektohet kushtetuta! Demokratja: Dy skandale të mëdha!
25 Mars, 2024

Berisha kërkon të lejohet të marrë pjesë në Parlament, GJKKO tërhiqet për të marrë vendimin, avokati Gjokutaj: SPAK kërkon ta trajtojë si të burgosur
25 Mars, 2024

BW App Store Download on the App Store GET IT ON Google Play

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT

Rizoto kremoz që shkrin në gojë
25 Mars, 2024

"Komisionet, njollë e zezë e parlamentarizmit", Petro Koçi nga komisioni hetimor për shëndetësinë: Shpallni aksionin opozitar se na mallëngjyet
25 Mars, 2024

Kek me muesli pa gluten
25 Mars, 2024

"Marrim kusi dhe kazanë", Korreshi ironizon te Komisioni Hetimor për shëndetësinë: Shpallni aksionin opozitar se na mallëngjyet
25 Mars, 2024

Debate në komisionin për koncesionin e sterilizimit dhe Check-Up/ Deputeti i PS kapet me Vokshin: Jo deklarata partiake, të respektohet kushtetuta! Demokratja: Dy skandale të mëdha!
25 Mars, 2024

Berisha kërkon të lejohet të marrë pjesë në Parlament, GJKKO tërhiqet për të marrë vendimin, avokati Gjokutaj: SPAK kërkon ta trajtojë si të burgosur
25 Mars, 2024

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2024 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.